

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjës të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.


Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit korrik, 2025

Paketa e ligjeve antikorrupsion plotësohet me tre projektakte të reja


1-31.07.2025: Hartimi i paketës së ligjeve antikorrupsion është shtuar me tre akte të tjera ligjore referuar rregullimit dhe sanksionimit të tre instrumenteve parandaluese të korrupsionit: sinjalizimi, sponsorizimet e donacionet dhe lobimi. Takime teknike dhe konsultative të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, të ngritur me tre urdhra të Kryeministrit, janë jetëzuar nën koordinimin e drejtpërdrejtë të ekipit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Projektligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve: Përgjatë muajit korrik 2025, u zhvilluan 4 takime të Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.65, datë 28.5.2025, dhe 4 takime të sekretariatit teknik. Kuadri i ri ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve pritet të linjëzohet me Direktivën e BE, 2019/1937 brenda vitit 2025. Ligji i ri pritet të garantojë më shumë mbrojtje për sinjalizuesit, mbrojtje në vendin e punës, përdorimin e rrugës gjyqësore si edhe mbrojtje nga hakmarrja në raste kërcënimesh. Mekanizmat e sinjalizimit do të shtrihen në shumë sektorë të veprimtarisë publike dhe në sipërmarrje me 50 persona staf. Projektligji pritet të shpallet për konsultim publik dhe për bashkërendim ndërmjet institucioneve publike.




Projektligji për sponsorizimet dhe donacionet në sektorin publik: Më 23.07.2025, u zhvillua takimi i parë (online) i Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.103, datë 17.7.2025. Hartimi dhe miratimi i një kuadri të ri dhe të konsoliduar ligjor për sponsorizimet dhe donacionet në Shqipëri do të harmonizojë këto dy mekanizma antikorrupsioni dhe do të rregullojë ndërveprimin e administratës publike dhe subjekte private që shfaqin interes për të bashkëpunuar me të. Kuadri i ri ligjor pritet të ngrejë struktura kontrolli dhe garantojë transparencën publike në marrjen dhe përdorimin e fondeve dhe mbështetjeve materiale dhe jo-materiale nga stafet administrative. Sekretariati teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit ka finalizuar analizën ligjore paraprake që do të shërbejë për hartimin e ligjit. Kjo iniciativë do të mbështetet nga projekti EU4GG i Delegacionit të BE në Tiranë deri në finalizimin e miratimit të ligjit.

Projektligji për lobimin në Republikën e Shqipërisë: Më 28.07.2025, u zhvillua takimi i parë (online) i Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.104, datë 17.7.2025. Ligji për lobimin është akti i parë që do të rregullojë këtë veprimtari në vend dhe do të ofrojë garanci për kontakte dhe marrëdhënie të funksionarëve publikë (politikë dhe teknikë) jashtë ndikimeve personale gjatë vendimmarrjes. Hartimi dhe konsolidimi i këtij akti ligjor do të asistohet nga zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, e cila gjithashtu ka mundësuar edhe përgatitjen e një analize ligjore paraprake për të.



Të tre këto nisma ligjore drejtohen nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj.Adea Pirdeni. Në përbërje të grupeve të punës janë përfaqësues të ministrave të Drejtësisë, të Financës, të Ekonomisë, të Arsimit dhe Sportit, Departamentit të Administratës Publike. Hartimi i tre ligjeve shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bazës ligjore për parandalimin e korrupsionit dhe ngritjen e standardeve të integritetit në administratën publike. Të tre këto akte ligjore së bashku me atë të konfliktit të interesit dhe të financimit të partive politike, që kanë filluar të diskutohen në Kuvendin e Shqipërisë do të plotësojnë kuadrin rregullator antikorrupsion të vendit.




Nis diskutimi institucional për ligjin “Për Lobimin”

21.07.2025: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit organizuan tryezën e parë kombëtare konsultuese për kuadrin ligjor “Për Lobimin”. Stafe teknike, përfaqësues nga Ministrinë e Linjës, institucione të pavarura, përfaqësues nga organet e drejtësisë u njohën me iniciativën ligjore për rregullimin e lobimit, si një mekanizëm bashkëpunimi që ndikon në proceset politikëbërëse dhe mund të përbëjë shkak për veprime korrupsioni. Tryeza u lehtësua nga ekspertja e Këshillit të Evropës, Vita Habbjan Barboric, e cila paraqiti dokumentin teknik për nevojën e hartimit të kuadrit ligjor të lobimit në Shqipëri. Aktualisht janë vetëm disa rregulla për lobimin për deputetët dhe ministrat duke pasur të parregulluar pjesën takuese për nivelin e lartë drejtues ekzekutiv dhe administrativ. Organet e pushtetit gjyqësor dhe autoritetet vendore janë gjithashtu jashtë këtij rregullimi. Parimet themelore të një ligji për lobimin, përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, mekanizmat për garantimin e transparencës në ndërveprimin midis sektorit privat dhe autoriteteve publike u diskutuar gjerësisht në këtë tryezë. Tryeza u mundësua nga Këshilli i Evropës, Tiranë në kuadër të projektit “Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”.

Administrata e qeverisjes vendore i bashkohet diskutimeve dhe njohjes me mekanizmat e integritetit

02.07.2025: Administrata e pushtetit vendor e 61 bashkive diskuton për riskun e korrupsionit dhe mekanizmat e integritetit. Punonjës të të gjitha niveleve pranë bashkive diskutuan për vlerësimin e riskut të integritetit si pjesë e performancës së tyre që ndikon në përfitimin e grantit të bazuar në performancë. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion mbështetur nga ekspertët e projektit EU4GG të Bashkimit Evropian në Tiranë ofruan udhëzime për administratën bashkiake për të rritur fokusin e tyre të veprimit ndaj mekanizmave të nevojshëm për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit, si dhe për menaxhimin efektiv të riskut të korrupsionit. Diskutimet dhe ndërveprimi mes tyre u përqendrua në rëndësinë e forcimit të kapaciteteve për integritet institucional, parandalimin e korrupsionit, si dhe në forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit në nivel vendor. Tryeza përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies, parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030. Administrata e bashkive do të jetë pjesë e vlerësimit të standardeve funksionale në vitet në vijim nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës.



Korrik 2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit procedon 5 masa administrative, 16 rekomandime dhe 1 kallëzim penal

1-31.07.2025: Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit ka vijuar me verifikimin e rasteve mbështetur në ankesa të marra nga qytetarë, indicie korrupsioni të marra nga stafi i Drejtorisë së Hetimit dhe Koordinatorët Antikorrupsion. Gjatë muajit korrik 2025, janë konkluduar 5 raporte përfundimtare nëpërmjet të cilëve janë propozuar 5 masa administrative dhe 16 rekomandime për autoritete publike dhe punonjës të tyre që nuk kanë respektuar kuadrin rregullator në fuqi. Këto masa janë adresuar kryesisht për punonjës të Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, si dhe për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Rekomandimet kanë patur në fokus kryesisht përmirësimin e zbatimit të ligjit, rishikimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të





brendshëm, garantimin e ofrimit të shërbimeve publike brenda afateve ligjore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe publikun. Një rast të dyshuar për shpërdorim detyrës (të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal) është depozituar depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të jetë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet për të ndjekur nga afër ecurinë e zbatimit të këtyre masave dhe rekomandimeve, duke siguruar një monitorim efektiv dhe mbështetje për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve administrative dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

20 vjet Shkolla Verore e RAI; UNCAC dhe UNTOC diskutohen për 3 ditë

2-04.07.2025: Iniciativa Rajonale Antikorrupsion – RAI, organizoi edicionin e 20-të të Shkollës Verore. Podgorica në Mal të Zi, mikpritësi pjesëmarrësit e 9 vendeve, anëtare në RAI, dhe tematika e diskutimit dhe analizimit ishin mekanizmat e rishikimit të Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe të Konventës Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC). Shqipëria u përfaqësua nga dy persona, staf ekspertësh nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Ministria e Brendshme. Programi i shkollës verore, ofroi njohuri mbi përmbajtjen e dy konventave dhe mënyrën se si vendet përgatiten për procesin e rishikimit të zbatimit, përfshirë organizimin e koordinimit kombëtar dhe bashkëpunimin me vendet vlerësuese. Pjesëmarrja në këtë shkollë verore forcon kapacitetet profesionale dhe mbështet angazhimet e Shqipërisë në kuadër të reformave kundër korrupsionit dhe integritetit evropian.



Korrupsioni në shëndetësi si problematikë për zgjidhje dhe promovim i mjeteve të tij

14.07.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga shoqata “Together for Life”, me fokus monitorimin e kryer në Tiranë për pagesa informale në qendrat shëndetësore publike. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe profesionistë të sektorit shëndetësor. Shoqata monitoruese prezantoi gjetjet e sondazhit dhe evidentoi shqetësimet publike që lidhen me korrupsionin në sektorin shëndetësor, ndikimin e tij në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe masat që mund të ndërmerren për të adresuar këtë fenomen. U theksua rëndësia e rritjes së transparencës institucionale, përmirësimit të mekanizmave të raportimit dhe ndërgjegjësimit qytetar. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kontribuoi në diskutim duke riafirmuar angazhimin për të promovuar qeverisjen e mirë, luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtës së qytetarëve për shërbime publike cilësore, transparente dhe të ofruara në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet etike. Tryeza u organizua në kuadër të projektit “Jashtë vëmendjes: Pagesa informale në marrjen e shërbimeve mjekësore në Shqipëri” (*Out of sight: Informal payments in receiving medical services in Albania*), të mbështetur nga Bashkimi Evropian duke dëshmuar në mënyrë të përsëritur që vetëm bashkëpunimi midis autoriteteve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të huaj janë bashkë në promovimin e perceptimit të publikut kundër korrupsionit.

